




ART EXPLORA FESTIVAL

ODYSSÉE
CULTURELLE
EN MÉDITERRANÉE

Pavijoni i fotografive RRYMË NËNUJORE

Kuratorë: Amanda Abi Khalil dhe Danielle Mekhoul (TAP)

Titulli i ekspozitës Rrymë nënujore / Contre; Courant i referohet rrymës nënujore, e cila lëviz në drejtimin e kundërt të rrymës sipërfaqësore që vihet re në sipërfaqe. Ekspozita eksploron në këtë mënyrë Detin Mesdhe, rrymat e tij sipërfaqësore dhe ato të thellësive: historitë që ndërthuren atje, eksperiencat njerëzore të cilat i lidh dhe mbi të cilat mbështetet. Për këtë arsye ai është një vend udhëtimi dhe mërgimi, shprese dhe zhgënjimi, jete dhe vdekjeje. Veprat e paraqitura - nga artistët nga rajone të ndryshme të pellgut të Mesdheut - pasqyrojnë një shumëllojshmëri këndvështrimesh që sfidojnë paragjykimet, shpesh të ngulitura mirë, për dukuritë e shpërnguljeve në rajon. Duke u dhënë hapësirë, zë dhe formë, veprat zbulojnë fuqinë e këtyre narrativave dhe protagonistët e tyre.

Konceptimi/realizimi: ma-tisse (www.ma-tisse.fr)
Faqosja dhe dizajni: Flore Beaudelin

© kreditet
Catherine Cattaruzza, I Can't Recall the Edges (Nuk mund t'i kujtoj kufijtë), 2016-2019
Sara Kontar, Therefore I Cut., (Prandaj i preva.), 2022,
Majd Abdel Hamid, Sketch (Skicë), 2023





Catherine Cattaruzza - Francë / Liban,
I Can't Recall the Edges (Nuk mund t'i kujtoj kufijtë), 2016-2019


Catherine Cattaruzza e fotografon **Bejrutin** prej disa vitesh (që nga viti 1992). Për këtë seri, ajo fotografoi **landfillin** publik që ndodhet përballë Mesdheut, Sasia e plehrave është kaq e madhe, sa formojnë pirgje që mbulohen gradualisht, duke krijuar në fund një **digë** natyrore. Fotografitë tregojnë zgjatime rëre, anije turistike dhe mbetje **rrënojash**.

? Çfarë mendoni për inkuadrimin e fotografive? Çfarë mund të tregojë sasia e plehrave lidhur me menaxhimin politik të këtij territori?

Nabila Hamil - Marok, *How deep is your love (Sa e thellë është dashuria jote), 2020*

Nabila Halim fotografon **pakot** e dërguara nga anëtarët e familjes tek ata që kanë emigruar. Nga kjo, artistja krijon një vepër e cila, në sipërfaqe, duket paradoksale: e lehtë nga ana materiale, vepra, siç sugjeron dhe titulli i saj, mbart një kuptim shumë të thellë. Dhjetë fotografitë e paraqitura këtu, si letra të lehta me motive shumëngjyrëshe, në fund të fundit shprehin më shumë se objekti i dërguar. Ato përmbledhin të gjithë simbolikën e "colis du bled" (pakos nga shtëpia), e cila formon **një lidhje të prekshme** me familjen, por shërben po ashtu si një kujtesë e origjinave, **identitetit** dhe **kulturës** së marrësit.

? Korrespondenca midis anëtarëve të familjes të ndarë nga emigracioni është thelbësore dhe ngre disa pyetje: si i ruan dikush lidhjet personale me familjen kur është në mërgim? Çfarë lloj memorieje kolektive krijon kjo korrespondencë midis njerëzve të afërt?



Lara Tabet - Liban, *Marseille/Overflow (Marsejë/Përmbytja), 2022 dhe Nitrate 001 (Nitrati 001), 2022*

Lara Tabet përdor **mostrat e ujit** nga Mesdheu dhe **bakteret** e tij për të krijuar fotografitë e saj. Motivet dhe ngjyrat janë rezultat i drejtpërdrejtë i reaksioneve kimike midis materialeve të ndryshme: qenieve të gjalla, dritës dhe **impresioneve fotografike**. Artistja krijon një dialog poetik mes analizës shkencore të jetës, padukshmërisë së baktereve, dhe zbulon një peizazh të panjohur nga thellësitë e oqeanit. Deti, koha e gjatë dhe mikroorganizmat janë përbërësit kryesorë të veprës së saj.

? A mendoni se bakteret dhe mikroorganizmat mund të zbulojnë gjurmë të pranishë njerëzore? A ndikojnë zhvendosjet e njerëzve te bakteret? Këto tema janë pjesë edhe e fushave me interes për Lara Tabet, pasi ajo është trajnuar si biologe mjekësore.

Randa Maroufi - Marok, *Liberation (Çlirimi) nga seria Nabila & Keltoum & Khadij, 2015; Bab Sebta, 2019*

Bab Sebta është, para së gjithash, një derë - ajo që e hap dhe mbyll **kufirin** midis dy shteteve të ndara nga Mesdheu. Është porta e Ceutës, një enklavë spanjolle në Marok. Ajo është gjithashtu vendi i trafikimit të gjithfarëllor mallrash (libra, veshje, ushqime etj.) që kalojnë nga një shtet në tjetrin. Skena është e rëndë, thellësisht njerëzore: ky trafikim i përditshëm, i përsëritur, është jetik për **mbijetesën** e shumë njerëzve. Por kur shihen nga lart, këto veprime, të cilat shkelin kufij dhe ligje, zbulojnë po ashtu fuqinë dhe **poezinë** e tyre.

? Narratori i filmit tregon marrëdhënien midis oficerëve të doganës dhe trafikantëve dhe metodat e përdorura nga këta të fundit për të anashkaluar ligjin. Këto objekte që kalojnë nga një shtet në tjetrin në një gjysmëligjshmëri, a nuk janë një pasqyrim i grave dhe burrave në mërgim? A mund të jetë titulli i fotografisë *Liberation (Çlirimi)* edhe një simbol i shpresës?



Bouchra Khalili - Marok, *Any (Straight Stories [Histori të çiltra] - Pjesa 2), 2008*

Any (Straight Stories [Histori të çiltra] - Pjesa 2) është pjesë e një serie filmash përmes të cilëve artistja Bouchra Khalili eksploron **mërgimin** dhe zonat **tranzite**, hapësirat që janë njëkohësisht të mbushura me **shpresë** dhe zhgënjim. Në këtë video, Anya, një grua e re nga Iraku, tregon udhëtimin e saj nga shteti i saj i origjinës. Ne nuk e shikojmë atë. Imazhet theksojnë **gjeografinë e përjetimit të saj**, këtu: Stambolli dhe Bosfori. Qyteti dhe ngushtica shfaqen plotësisht të vërteta dhe, në të njëjtën kohë, pothuajse si fantazma, nëpërmjet këtij zëri që tregon për to.

? Vini re imazhet e këtij filmimi gjurmues që udhëton nga ana aziatike e ngushticës për në anën evropiane. Çfarë ndjesie shkakton lëvizja e kamerës? Pikërisht para përfundimit të filmit, dëgjohet kjo fjali: "Kur do të mund të kem një jetë të qetë?"...

Majd Abdel Hamid - Siri, *Muscle Memory (Memoria e muskujve), 2022*

Duke përdorur fotografitë që i bën qytetit të Bejrutit, Majd Abdel Hamid krijon memorie vizuale, duke pasqyruar mënyrën se si e përjeton ai qytetin. Ai më pas shkëput motive (arkitekturore, shumëngjyrëshe etj.), i ripërshtat dhe i qëndis ato. Përmes këtij procesi, artisti kërkon motivin që do të simbolizojë Bejrutin, në një kuptim, identitetin e tij. Ai po ashtu ringjall një traditë të trashëguar nga kultura e tij palestineze, ku çdo motiv i zbukuruar korrespondon me një rajon specifik.

? Procesi krijues i Majd Abdel Hamid vë në dyshim marrëdhënien midis një individi dhe vendit ku jeton, si dhe lidhjen midis përjetimit subjektiv dhe identitetit kolektiv. A është vallë qyteti rezultat i historive të individëve që jetojnë në të apo mos vallë çdo individ është produkt i vendit ku banon?



Imane Djamil - Marok, *Slow Days in the Fortunate Isle (Ditë pa lëvizje në Ishullin e të Bekuarve), 2021-2024*

Këto fotografi u bënë në ishullin e Fuerteventura, ishulli i dytë më i madh i Ishujve Kanarie në Spanjë. Midis zgjatimeve të **rërës** së bardhë dhe **Oqeanit** Atlantik, ishulli është vetëm 100 km larg nga bregdeti maroken dhe bën pjesë në një nga **rrugët** më vdekjeprurëse të **emigracionit**. Imane Djamil përdor këtu **doku-fiksionin** për të zbuluar atmosferën e peizazhit dhe anën e tij **surreale**. Artistja është frymëzuar gjithashtu nga mitologjia greke e Ishujve të të Bekuarve - që simbolizojnë lumturinë - të cilët, përgjatë shekujve, janë lidhur me Ishujt Kanarie.

? Me çfarë e lidhni vizatimin e hartës: një gjueti thesari apo një itinerar udhëtimi? Çfarë emocionesh mbizotërojnë kur përballeni me këto fotografi: gëzimi, frika apo ankthi? Përpikuni të kuptoni pse dhe nga se krijohen këto emocione.